



Dogana dhe AKSHE Forcojnë Mbrojtjen e Flukseve Tregtare Ushtarake



» faqe 3



PRESIDENTI BAJRAM BEGAJ DHE SHSHPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI, PRITËN GJENERALMAJOR ULUTAŞ PËR SIGURINË NË BALLKAN

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, priti sot në një takim zyrtar Komandantin e Misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), gjeneralmajor Özkan Ulutaş. Kreu i Shtetit shprehu vlerësimin për marrjen e mandatit të dytë të Komandantit të KFOR-it nga Turqia dhe mirënjohjen...



» faqe 2



UNIFORMA QË FORMON NJERËZ: Nga agimi i Bunavisë te betimi për atdheun

Në agimin e çdo dite, përpara se dielli të ngjitet mbi kodrat e Bunavisë, ajri i ftohtë përziehet me zërin e ziles që dëgjohet në orën 05:55. Ky tingull, i cili shënon fillimin e ditës për studentët e vitit të parë të Akademisë së Forcave të Armatosura, është shumë më tepër se një zgjim...



» faqe 8



HIPOKRIZIA, MASKA E NJERËZIMIT NË KOHËN MODERNE

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në çdo epokë, njeriu është përpjekur të kuptojë vetveten, të mirën dhe të keqen, dritën dhe errësirën, njeriun dhe djallin brenda tij. Por sot, në një shoqëri që përparon me shpejtësi në teknologji e pasuri materiale, duket se një vlerë themelore po humbet: ndershmëria...



» faqe 7

Presidenti Bajram Begaj dhe SHSHHPFA, Gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën gjeneralmajor Ulutaş për sigurinë në Ballkan

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, priti sot në një takim zyrtar Komandantin e Misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), gjeneralmajor Özkan Ulutaş. Kreu i Shtetit shprehu vlerësimin për marrjen e mandatit të dytë të Komandantit të KFOR-it nga Turqia dhe mirënjohjen për angazhimin e trupave të saj në misionin e paqes në Kosovë.

Gjatë bisedës u theksua rëndësia e misionit për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, si dhe nevoja për bashkëpunim të ngushtë mes KFOR-it dhe institucioneve të Kosovës, veçanërisht me Forcën e Sigurisë së Kosovës, për zhvillimin, modernizimin dhe transformimin e saj sipas standardeve të NATO-s. Presidenti Begaj rikofirmoi mbështetjen e Shqipërisë ndaj misionit dhe nënvizoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit rajonal për paqe dhe siguri.

Në vazhdim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben



Presidenti Begajaj priti Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş, në vizitë zyrtare në Shqipëri



SHSHHPFA gjenerallejtënant Arben Kingji priti Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş

Kingji, priti gjithashtu gjeneralmajor Ulutaş. Gjatë takimit u diskutua situata e përgjithshme e sigurisë, sfidat dhe kërcënimet në Ballkanin Perëndimor, si dhe roli i vazhdueshëm i misionit KFOR për stabilitetin rajonal. Gjenerallejtënant Kingji konfirmoi angazhimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për mbështetjen të vazhdueshme të KFOR-it.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Ulutaş, falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe vlerësoi profesionalizmin dhe kontributin e trupave shqiptare në kuadër të misionit. Në përfundim të takimeve, të dy autoritetet vlerësuan përpjekjet e përbashkëta për përmirësimin e sigurisë në Kosovë dhe rajon.



Gjenerallejtënant Arben Kingji në Ekspozitën Ndërkombëtare të Industrisë së Mbrojtjes në Slloveni

Siguria rajonale në fokus: Pjesëmarrja e Shqipërisë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, me ftesë të homologut slloven, gjenerallejtënant Robert Glavaš, mori pjesë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Industrisë së Mbrojtjes, ku u prezantuan produktet më të fundit në fushën e mbrojtjes.

Gjatë aktivitetit u theksua rëndësia e inovacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë, si dhe mundësitë për shkëmbim të njohurive teknike dhe eksperiencës midis forcave dhe industrive mbrojtëse të vendeve pjesëmarrëse.

Gjenerallejtënant Kingji shfrytëzoi rastin për të vlerësuar kontributin e kompanive dhe institucioneve pjesëmarrëse në avancimin e kapaciteteve të mbrojtjes, duke nënvizuar rolin e bashkëpunimit në fuqizimin e sigurisë rajonale dhe kombëtare.



Faza e parë e Maratonës Kombëtare për Sigurinë Kibernetike përmbyllet me sukses

U përmbyll me sukses faza e parë e Maratonës Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, një nismë që synon të nxisë kulturën e sigurisë digjitale dhe zhvillimin e aftësive teknologjike të rinjtë. Në këtë fazë të parë u dalluan tre universitetet dhe studentët më të suksesshëm, të cilët u renditën në vendet e para për rezultatet e tyre të larta dhe përgatitjen profesionale në fushën e sigurisë kibernetike. Kjo garë, e cila zhvillohet në disa faza, do të vijojë me tre raunde të tjera sfiduese, për t'u përmbyllur me finalen kombëtare në muajin dhjetor. Qëllimi i Maratonës është të krijojë një hapësirë bashkëpunimi mes institucioneve arsimore, strukturave të sigurisë dhe komunitetit të teknologjisë, në mënyrë që të forcohet rezistenca ndaj kërcënimeve kibernetike dhe të promovohet inovacioni në këtë fushë jetike për sigurinë kombëtare.

Urime studentëve dhe universiteteve fituese, si dhe suksese të gjithë pjesëmarrësve në fazat e ardhshme të kësaj sfide kombëtare!



Dogana dhe AKSHE Forcojnë Mbrojtjen e Flukseve Tregtare Ushtarake

Hap i Ri Strategjik për Forcat e Armatosura: Kontroll i Plotë i Eksporteve Kritike

Në ambientet e Ministrisë së Financave u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

Marrëveshja u firmos nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli, dhe Drejtori i AKSHE-së, z. Andrea Shllaku, në prani të ministrit të Financave, Petrit Malaj, dhe ministrit të Mbrojtjes, Pirro Vëngu.

Ky akt institucional synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për lehtësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta në fushën e kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe atyre ushtarake.

Nëpërmjet marrëveshjes, palët angazhohen për krijimin e një platforme efektive komunikimi dhe shkëmbimi informacioni, si dhe për ofrimin e asistencës teknike gjatë identifikimit dhe klasifikimit të mallrave që hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 46/2018 dhe Kodin Doganor.

Marrëveshja formalizon bashkërendimin e veprimeve për kontrollin e flukseve tregtare strategjike dhe përcakton qartë format e ndërveprimit dhe detyrat përkatëse të secilit institucion, duke garantuar shkëmbim të shpejtë dhe efikas



të informacionit. Gjithashtu, parashikohet realizimi i analizave të përbashkëta të riskut për minimizimin e rreziqeve të transferimeve ndërkombëtare të mallrave

ushtarake dhe atyre me përdorim të dyfishtë, si dhe parandalimin e trafikut të tyre të paligjshëm.

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve

profesionale, ekspertët e të dy institucioneve do të angazhohen në hartimin e planeve dhe programeve të trajnimit, për rritjen e njohurive teorike dhe praktike të personelit doganor në fushën e sigurisë dhe mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje pritet të sjellë rezultate të prekshme në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, përmirësimin e kohës së reagimit dhe verifikimit, forcimin e mbrojtjes kundër përdorimeve të paligjshme të mallrave strategjike dhe përputhshmërinë e plotë me standardet ndërkombëtare të kontrollit të eksporteve.

Ky bashkëpunim ndërmjet Doganës dhe AKSHE-së përbën një shembull të suksesshëm të partneritetit ndërinstitucional, duke kontribuar drejtpërdrejt në garantimin e sigurisë kombëtare, mbrojtjen e interesave strategjike të shtetit dhe përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë.

Ringritja e Industrisë Ushtarake kërkon një qasje të re nga agjencitë ligj zbatuese në kontrollin e mallrave strategjike, dhe marrëveshja e sotme shënon një hap të ri drejt linjësimit të plotë me normat dhe standardet e Bashkimit European.



Bunavi, ku disiplina dhe nderi ndërtojnë ushtarët e së ardhmes

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vëngu, vizitoi Qendrën e Arsimit Profesional të Akademisë së Forcave të Armatosura në Bunavi, ku përshëndeti 149 rekrutët e rinj dhe 76 kadetët e vitit të parë, që sapo kanë nisur rrugëtimin e tyre në uniformë.

"Bunavia" mban një status të veçantë brenda Forcave të Armatosura, si një repart ku disiplina është e hekurt dhe ku vullneti për t'i shërbyer vendit kalitet çdo ditë", - theksoi ministri gjatë vizitës.

Gjatë qëndrimit, ministri Vëngu inspektoi punimet e rehabilitimit të godinave të bazës, si pjesë e fazës së parë të modernizimit të saj. Ai nënvizoi se investimet në infrastrukturë do të pasohen nga përmirësime në teknologji, mjete dhe sisteme, për t'iu përgjigjur nevojave të reja të formimit ushtarak.

Në Bunavi ka nisur gjithashtu dislokimi i një kompanie të sapokrijuar të Bazës Mbështetëse të Emergjencave Civile, duke forcuar kapacitetet e mbrojtjes civile në Jug-Perëndim të vendit.

Ministri shprehu respekt dhe mirënjohje për të gjithë personelin akademik, instruktorët dhe ushtarët e Bunavisë, që përditë mishërojnë disiplinën, përkushtimin dhe nderin e uniformës.



Rrugëtimi i ri në uniformë: Ministri Vëngu viziton rekrutët dhe kadetët e AFA



Baza Ajrore Farkë, një ditë ndryshe për ushtarakët dhe vizitorët e vegjël

Një ditë e veçantë u zhvillua së fundmi në Bazën Ajrore të Farkës, ku zëri i avionëve dhe mekanizmave ushtarakë u shoqërua me të qeshurat e gëzueshme të fëmijëve. Një grup nxënësish nga shkolla e qytetit vizituan bazën dhe patën mundësinë të njihen nga afër me mjetet dhe pajisjet që përdorin Forcat e Armatosura.

Të shoqëruar nga personeli ushtarak, vizitorët e vegjël panë dhe preken nga afër avionët, helikopterët dhe automjetet ushtarake, duke marrë shpjegime për funksionimin dhe rëndësinë e secilit prej tyre në mbrojtjen e vendit. Pasi kaluan nëpër hangarët dhe platformën e aeroplanëve, fëmijët shprehën kuriozitetin e tyre për çdo detaj, duke bërë pyetje pa fund për mënyrën se si fluturojnë avionët, si operojnë pajisjet elektronike dhe si ushqehen pilotët gjatë misioneve.

Njëri prej instruktorëve që shoqëroi vizitorët e vegjël u shpreh se: “Aktivitete të tilla nuk janë thjesht një mundësi që fëmijët të shohin nga afër Forcat e Armatosura, por janë një mundësi për të frymëzuar tek ta disiplinën, përgjegjësinë dhe ndjenjën e shërbimit ndaj atdheut”.


Vizita nuk përfundoi vetëm me kuriozitetin e treguar ndaj mjeteve ushtarake, por ata morën pjesë



në demonstrime të vogla praktike, ku mësohen bazat e sinjalistikës, disiplinës dhe bashkëpunimit në ekipe. Entuziazmi ishte i dukshëm në çdo moment, ndërsa fëmijët përfituan edhe nga këshillat e ushtarakëve të rinj, të cilët ndanë me ta përvojat e tyre personale dhe rrugëtimi drejt karrierës

ushtarake.

Ky aktivitet është pjesë e një programi më të gjerë të Forcave të Armatosura, që synon të afrojnë dhe të njohin fëmijët dhe të rinjtë me misionin e ushtrisë, duke nxitur interesin për profesionin ushtarak dhe duke edukuar brezin e ri në frymën e



përgjegjësisë qytetare dhe patriotizmit.

Dita në Bazën Ajrore të Farkës la tek vizitorët e vegjël kujtime të paharrueshme, kurse ushtarakët e bazës konfirmuan rëndësinë e këtij angazhimi në formimin e lidhjes mes komunitetit dhe strukturave të mbrojtjes kombëtare.



Operatorët EOD garantojnë siguri për qytetarët përmes pastrimit të territorit nga municionet e paplasura

Operatorët EOD të Batalionit të Xhenios kanë realizuar me sukses një sërë detyrash për pastrimin e territorit nga municione të rrezikshme të identifikuar në bashkitë Përrenjas, Himarë dhe Elbasan.

Në çdo rast, ekipet e specializuara kanë kryer me kujdes kontrollin, vlerësimin, transportimin dhe asgjësimin e municioneve luftarake, duke siguruar eliminimin e çdo rreziku potencial për komunitetin.

Përmes këtij angazhimi të përditshëm, efektivët e Batalionit të Xhenios kontribuojnë drejtpërdrejt në garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e jetës e pronës nga kërcënimet që vijnë nga municionet e mbetura të paplasura.



Xhenierët e Kompanisë së Urave riparojnë urën metalike “Bailey” mbi lumin Drin

Ekspertët xhenierë të Kompanisë së Urave kanë nisur punimet për riparimin e urës metalike tip “Bailey”, mbi lumin Drin, në njësinë administrative Muhurr, bashkia Dibër.

Operacioni përfshin ndërrimin e elementëve të dëmtuar dhe centrimin e strukturës, me synim rikthimin e funksionalitetit të plotë të urës dhe garantimin e sigurisë për përdoruesit. Pas përfundimit të ndërhyrjes, ura “Bailey” do të ketë një strukturë të përforcuar, pamje të përmirësuar dhe kapacitet më të lartë mbajtës, duke siguruar kushte më të mira për lëvizjen e banorëve dhe automjeteve në zonë.



Tradita e humanizmit në uniformë: Forca Tokësore në mbështetje të fëmijëve talasemikë

Ushtarakët e Batalionit të Tretë të Këmbëorisë në Korçë dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë dhe personat në nevojë

Në kuadër të nismës humanitare “Dhuroni gjak, shpëtoni jetë!”, ushtarakët e Batalionit të Tretë të Këmbëorisë, pjesë e Regjimentit të Këmbëorisë së Jugut në Forcën Tokësore, vijuan sot traditën e dhurimit vullnetar të gjakut për fëmijët talasemikë dhe personat në nevojë.

Pas një fushate sensibilizuese të zhvilluar nga personeli mjekësor i Degës së Shëndetësisë dhe Degës së BCU-së, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, 27 ushtarakë iu bashkuan kësaj nisme humane, duke dhënë shembull të përkushtimit dhe humanizmit që karakterizon trupën ushtarake shqiptare.

Ky aktivitet vlerësohet si një akt solidariteti dhe përgjegjësie qytetare, që tregon se shërbimi ndaj jetës dhe komunitetit është pjesë e pandarë e misionit të çdo ushtaraku. Faleminderit të gjithë atyre që kontribuojnë me gjestin më fisnik, dhurimin e gjakut për të shpëtuar jetë!



Momente frymëzuese u përcollën sot gjatë nisjes së rekrutëve të rinj që do të zhvillojnë fazën stërvitore në qendrat trajnuese të Bunavisë, Zall-Herrit dhe Vaut të Dejës. Me vendosmëri dhe ndjenjë të lartë detyre, ata hedhin hapat e parë në rrugën e nderuar të shërbimit në uniformë.

Familjarë, përfaqësues të strukturave ushtarake dhe instruktorë ishin të pranishëm për t'i uruar suksese në këtë etapë të rëndësishme të jetës së tyre, ku përkushtimi, disiplina dhe ndjenja e përgjegjësisë për vendin shënojnë filluesën e formimit të ushtarakut të ardhshëm.

Këta të rinj do të ndjekin programet bazë të stërvitjes ushtarake, duke u përgatitur fizikisht, profesionalisht dhe shpirtërisht për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Urojmë suksese dhe shërbim me nder e dinjitet për secilin prej tyre, në këtë rrugëtim të ri në shërbim të Atdheut!



Hapi i parë në shërbim të Atdheut: Rekrutët drejt Bunavisë, Zall-Herrit dhe Vaut të Dejës

Rrugëtimi i nderit dhe detyrës: Rekrutët drejt qendrave stërvitore



Tre anije italiane vizitojnë ujërat territoriale shqiptare

Tre anije të Forcës Detare italiane vizituan ujërat territoriale shqiptare, në kuadër të stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta me Forcat Detare të Shqipërisë.

Nënadmiral Adnand Agastra, Komandant i Forcës Detare / Rojës Bregdetare, zhvilloi një vizitë zyrtare në bordin e anijes SPICA, ku u prit nga Kundëradmirali Davide De Pozzo dhe Komandanti i anijes SPICA.

Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet forcave detare të dy vendeve dhe mbi çështjet e sigurisë rajonale detare. Po ashtu, u zhvillua një përshëndetje përmes video-transmetimit (VTC) me Komandantin e Flotës italiane, Nënadmiralin Aurelio De Carolis.

Ky aktivitet i përbashkët synon forcimin e bashkëpunimit operacional të Forcave Detare të Shqipërisë dhe Italisë. Anija SPICA është e klasit CASSIOPEA, ndërsa anija simotër LIBRA pritet të bashkohet së shpejti flotës së Forcës Detare Shqiptare, duke shtuar kapacitetet operative të saj.



Rritet ndërveprimi rajonal, K1K stërvitet me Malin e Zi për misionin eVA

Stërvitja e përbashkët me Malin e Zi përgatit efektivet për misionin eVA në Bullgari Toga e Armëve të Rënda K1K, pjesë e Batalionit të Parë të Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me efektive të palës malazeze, me temë: “Lëvizjet dhe taktikat në operacione urbane”.

Stërvitja u zhvillua në ambientet e ROS dhe kishte për qëllim rritjen e ndërveprimit, shkëmbimin e përvojave taktike dhe përgatitjen e trupave për pjesëmarrjen në misionin eVA në Bullgari.

Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale të trupave shqiptare në përmbushjen e detyrave ndërkombëtare.



GRATË QË MBAJTËN KOMBIN MBI SUPE: NGA NORA E KELMENDIT TE NËNË TEREZA

Gratë sakrifikuese që e ngjiten në altar misionin e nënës

NGA REDAKSIA
E GAZETËS USHTRIA

Në historinë e popullit shqiptar, pak figura mbartin peshën dhe madhësinë që ka nëna shqiptare. Ajo qëndron në themelet e identitetit tonë kombëtar, në çdo brez dhe në çdo kohë, si një shtyllë e qëndresës morale dhe shpirtërore. Në tekstin “Gratë sakrifikuese që e ngjiten në altar misionin e nënës”, ndeshemi me një përjetim të thellë, një homazh poetik dhe njerëzor për gruan që ka lindur, rritur dhe mbrojtur jetën në çdo stinë të vështirësisë.



dhe që vë jetën në rrezik për dinjitetin e kombit.

Shote Galica (Qerime Radisheva)

Grua e armëve, bashkëshorte e trimit Azem Galica, por mbi të gjitha nënë e luftës dhe e idealeve kombëtare. Në një kohë kur shumë gra nuk dilnin nga shtëpia, ajo mori pushkën në krah dhe luftoi në krah të burrave për çlirimin e Kosovës. Në fjalët e saj të fundit: “Shqipëria e lirë le të rrojë, se unë po vdes e qetë”, gjendet trimëria e nënës që nuk njeh frikë.

Nënë Pashako

Një figurë popullore e Luftës Nacionalçlirimtare. Kur i ra djali dëshmor, ajo doli para njerëzve dhe tha:

“Mos qani, djali im ra për Shqipërinë, e unë do t’i rris të tjerët për të njëjtin flamur”.

Kjo është trimëria e dhimbjes së përmbajtur, e nënës që shndërron lotin në forcë, si shumë nëna të atyre viteve.

Nënë Zaharia nga Dibra

Në kohën e pushtimit osman, ajo mbajti të fshehur luftëtarët shqiptarë në shtëpinë e saj, duke rrezikuar jetën e familjes. Kur u pyet pse nuk u tremb, ajo tha:

“Nëse më marrin jetën, s’kam humbur gjë; nëse humbet Shqipëria, humbasim të gjithë”.

Nënat e Kosovës (1998–1999)

Edhe në kohët moderne, trimëria e nënave nuk mungon. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, nënat shqiptare mbajtën gjallë fëmijët

Sakrifika që shndërrohet në shenjtëri

Fotografia e gruas shqiptare që mban djepin në shpinë me fëmijën brenda tij është shumë më tepër se një kujtim nga e kaluara. Ajo është një ikonë e përvetshme e vetëmohimit. Në çdo hap, ajo bartte jo vetëm peshën e trupit të fëmijës, por edhe peshën e përgjegjësisë, të dashurisë dhe të ekzistencës. Nëna e përshkruar në këtë tekst është gruaja që, edhe pse e lodhur nga puna e rëndë, nga shiu dhe erërat e stuhishme, nga pritjet e pafundme, nuk e ndan fëmijën nga vetja. Ajo është strehë, mburojë dhe jetë, një simbol që përmbledh të gjitha format e përkushtimit njerëzor.

Nëna, misionare e jetës dhe trashëgimisë

Në çdo fjali të këtij materiali, nëna ngrihet në pedestalin e nderimit.

Ajo nuk pranon të jetë “e përçmuar nga kodet zakonore”, por e shpall veten misionare të jetës dhe trashëgimisë së brezave. Në trupin e saj fillon jeta, në kraharorin e saj ushqehet dashuria, dhe në duart e saj formohet njeriu i ardhshëm. Në këtë dimension, nëna shqiptare bëhet simbol i vijimësisë së kombit, ashtu si ushtari që ruan kufijtë e vendit, ajo ruan kufijtë e shpirtit, të traditës dhe të qëndresës sonë.

Një mësim për brezat e sotëm

Nëna shqiptare e dikurshme, që shkelte mbi baltë me djepin në shpinë, përfaqëson thelbin e fortësisë që çdo brez duhet ta njohë e ta nderojë.

Ajo s’kërkoi kurrë lavdi, as përmendore; kërkoi vetëm të shihte fëmijën e saj të rritur, të shëndetshëm dhe të ndershëm. E megjithatë, siç e thekson autori, “shpirti i plasi për një fjalë të mirë dhe një dorë që i’a paqton dhimbjet”, një kujtesë se mirënjohja është detyrimi më fisnik i çdo shoqërie ndaj nënës.

Nëna, ushtarja e parë e jetës

Nëna shqiptare është ushtarja e parë e jetës, ajo që ka mbrojtur kombin në heshtje, pa armë, por me zemër, me duar të lodhura dhe me shpirt të pathyeshëm. Ashtu si çdo ushtar që mbron atdheun në kufi, ajo ka mbrojtur jetën në vatrën e saj. Nëna është forca morale e një ushtrie të tërë populli, që ka ditur të mbijetojë, të punojë e të shpresojë, edhe në kohët më të errëta.

Altari i mirënjohjes

Figura e nënës shqiptare nuk i përket vetëm të shkuarës; ajo është trashëgimi shpirtërore e kombit tonë. Sot, kur shoqëria përpiqet të ruajë vlerat dhe të ndërtojë të ardhmen mbi themele të forta, nderimi për nënën është nderimi për jetën vetë. Nëna është, dhe do të mbetet, altari i përvetshëm i dashurisë, i sakrificës dhe i qëndresës. Figura e nënës shqiptare nuk është vetëm simbol i dashurisë e përkushtimit, por edhe i trimërisë dhe guximit, shpesh të heshtur, por të thellë dhe madhështor.

Nënë Tereza (Gonxhe Bojaxhiu)

Edhe pse jo në kuptimin luftarak të trimërisë, ajo është nëna shpirtërore e njerëzimit. Trimëria e saj qëndron në përballjen me varfërinë, sëmundjet dhe vdekjen me dashuri e mëshirë. Në kohë kur shumë e shmangnin mjerimin, ajo u fut në zemrën e tij për t’i shërbyer njerëzimit me mirësi.

Nora e Kelmendit

Një nga figurat më të fuqishme të historisë shqiptare. Me zgjuarsi e guxim, ajo vrau pashain turk që kishte përdhunuar ndershmërinë e fshatit të saj.

Trimi mund të ngrejë armën, por Nora ngriti nderin dhe e mbrojti me gjak.

Ajo është simbol i nënës dhe gruas që s’e pranon poshtërimin

në mërgim, në male e në kampe, shpesh pa bukë e pa ujë, por me shpresë. Ato janë heroina të heshtura, që ruajtën jetën në kohë kur vdekja ishte e përditshme.

Nënë Hava Rexha, nëna e dëshmorëve

Nga Malësia e Gjakovës, nënë që humbi disa nga djemtë në luftë, por që doli para popullit dhe tha me krenari:

“Unë nuk qaj për bijtë që dhanë jetën, qaj për ata që s’e duan lirinë si ata.”

Një shembull i trimërisë morale, që tejkalon frikën dhe dhimbjen.

Nënat e fshatrave që mbajtën jetën gjallë

Edhe pse pa emra në libra, ato janë nënat e zakonshme që mbollën bukë, ruajtën fëmijët, bartën plagët e burrave dhe s’u përkulën kurrë.

Në çdo shtëpi shqiptare, ka një nënë që ka treguar trimëri, në heshtje, në sakrificë, në dashuri.

Në historinë tonë, trimëria nuk është vetëm ajo që ngre armën, por ajo që mbron jetën, dinjitetin dhe shpresën. Nëna shqiptare e ka bërë këtë për shekuj me radhë, dhe për këtë arsye, ajo është dhe mbetet ushtarja e parë e jetës.

Gazeta Ushtria

Në nderim të grave sakrifikuese që e ngjiten në altar misionin e nënës –

nëna shqiptare, simbol i paepur i dashurisë, jetës dhe atdheut.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Njeriu ndërmjet sinqeritetit dhe hipokrizisë

Në çdo epokë, njeriu është përpjekur të kuptojë vetveten, të mirën dhe të keqen, dritën dhe errësirën, njeriun dhe djallin brenda tij. Por sot, në një shoqëri që përparon me shpejtësi në teknologji e pasuri materiale, duket se një vlerë themelore po humbet: ndershmëria.

Sytë që qeshin, por zemra që tradhton

“Ç’do çast në sy të buzëqesh./ Të flet ëmbël sikur më parë./ Por ai pret ditën që të ta ngjeshë./ Me thikë pas shpine për të të vrarë.”

Në një botë ku fasada vlen më shumë se përmbajtja, njeriu është kthyer në maskë.

Shoqëria e fasadave dhe kultura e dukjes

Rrjetet sociale, marrëdhëniet sipërfaqësore dhe karrierizmi pa vlera, kanë krijuar një kulturë të re: atë të dukjes, jo të qenies. Në këtë botë, hipokrizia lulëzon. Secili përpiqet të shfaqet “i përsosur”, ndërsa realiteti shpirtëror është gjithnjë e më bosh.

Si mund të ndërtohet një shoqëri e drejtë kur themelet e saj qëndrojnë mbi mashtrimin dhe vetë-gënjeshtren?

Filozofia e ndershmërisë

Ndershmëria, edhe pse shpesh shihet si dobësi, është forca më e madhe që mund të ketë njeriu. Ai që qëndron i drejtë edhe kur e sulmojnë, është fitimtari i vërtetë, jo ai që fiton me mashtrim.

NË JETËN E PËRDITSHME, HIPOKRIZIA ËSHTË BËRË PJESË E ZAKONSHME E MARRËDHËNIEVE TONA. NJERËZIT NDIHEN TË DETYRUAR TË PARAQESIN NJË VERSION TË PËRKRYER TË VETES, DUKE FSHEHUR DOBËSITË. POR KJO SJELL NDARJE TË BRENDASHME, STRES DHE MUNGESË AUTENTICITETI.

Hipokrizia, plagët e moralit modern

Në jetën e përditshme, hipokrizia është bërë pjesë e zakonshme e marrëdhënieve tona. Njerëzit ndihen të detyruar të paraqesin një version të përkryer të vetes, duke fshehur dobësitë. Por kjo sjell ndarje të brendshme, stres dhe mungesë autenticiteti.

Kështu lind ndërprerja midis fjalës dhe veprës, ku njeriu nuk di më kush është veçse një imazh i vetvetes.

Të dukesh apo të jesh?

Hipokrizia është mospërputhja mes fjalëve dhe veprave. Hipokriti kërkon miratim kërkon pushtet, por në fund, humb kontaktin me të vërtetën.

Sjellje kjo që shkatërron jo vetëm marrëdhëniet njerëzore, por edhe shëndetin mendor dhe shpirtëror. Jetesa me maskë sjell lodhje, stres dhe zbrazëti. Dhe pa e kuptuar ka humbur lidhjen me veten.

Sinqeriteti si akt guximi

Hipokrizia është sëmundje e ndërgjegjes njerëzore, që lindin kur njeriu humb lidhjen me të vërtetën. Të jetosh sipas vullnetit të Zotit do të thotë të jesh i pastër në zemër, i drejtë në veprime dhe i përlurur në shpirt.

Në një shoqëri që na shtyn të dukemi më shumë sesa të jemi, sinqeriteti është guxim. Vetëm kur guxojmë të jemi të vërtetë, mund të ndërtojmë marrëdhënie të shëndetshme dhe një paqe të brendshme që nuk ka nevojë për maska.

Në një botë me shumë fasada, të jesh i vërtetë është revolucion

Autenticiteti nuk është thjesht një vlerë personale, por një akt i guximshëm dhe shpesh i rrezikshëm. Në një shoqëri ku retorika e madhështisë, deklaratat e bukura dhe sjellja e përshtatur janë norma, të shfaqësh të vërtetën tënde kërkon sfidim.

Ai që zgjedh sinqeritetin mbi hipokrizinë shpesh rrezikon të përballlet me paragjykime, izolim apo mospranim. Por ky është çmimi i lirisë morale.

Hipokrizia, ndërkohë, vepron si një helm i heshtur. Ajo kthen marrëdhëniet njerëzore në lojë interesash dhe maskimesh, duke fshirë lidhjen autentike midis individëve. Një njeri i vërtetë, nga ana tjetër, nuk shkon gjithmonë përputhje me pritshmëritë; ai ose ajo sfidon normat, por krijon një hapësirë për besueshmëri dhe integritet. Ky tension midis dukjes dhe thelbit është një nga paradokset më të mëdha të jetës shoqërore moderne.

Të qenit i vërtetë nuk është vetëm një akt personal, por një provokim etik. Ai që zgjedh transparencën mbi hipokrizinë nuk ndërton vetëm karakterin e tij, por shërben si shembull dhe sfidë për komunitetin.

Në një epokë të mbushur me fasada, çdo veprim i sinqertë është një revolucion i heshtur, por i fuqishëm.

Në një botë ku maskat janë normë, autenticiteti shndërrohet në akt rebel. Hipokrizia është fitore e përkohshme, por e vërteta është trashëgimi.

Revolucioni i brendshëm i secilit prej nesh fillon aty ku vendosim të jemi të sinqertë, edhe kur e gjithë bota duket se kërkon të ndryshe.

UNIFORMA QË FORMON NJERËZ: Nga agimi i Bunavisë te betimi për atdheun

Qendra e Arsimit Profesional
të Ushtarit, Bunavi

Në agimin e çdo dite, përpara se dielli të ngjitet mbi kodrat e Bunavisë, ajri i ftohtë përzihet me zërin e ziles që dëgjohej në orën 05:55. Ky tingull, i cili shënon fillimin e ditës për studentët e vitit të parë të Akademisë së Forcave të Armatosura, është shumë më tepër se një zgjim i zakonshëm, është sinjali i një transformimi të thellë, rrugëtimi që i shndërron të rinjtë civilë në ushtarakë të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarit (QAPU), Bunavi, çdo mëngjes nis me një ndjenjë përgjegjësie dhe përkushtimi. Brenda pak minutash, korridoret mbushen me zhurmën e këmbaleve dhe me zërat e komandave që përplasen mbi muret e bardha të fjetinës. Në sheshin e rreshtimit, ajri i pastër i mëngjesit përzihet me frymën e bashkimit. Studentët formohen në rresht, ndërsa komandantët japin urdhrat e para të ditës.

Ritmi i disiplinës dhe sfidës

Në orën 06:00, me komandën “Në vend! Filloni përgatitjen fizike!”, sheshi gjallërohet. Vrap i mëngjesit, i shoqëruar nga këngë me frymë patriotike, shndërrohet në një himn të vendosmërisë dhe qëndrueshmërisë. “Çdo hap është një hap drejt forcës, çdo frymëmarrje është betim për Atdheun”, thotë një prej instruktorëve, ndërsa studentët kalojnë përmes pistës së stërvitjes me një ritëm që bashkon trupin dhe shpirtin në një të vetme.

Pas ushtrimeve fizike, vjen momenti i përkujdesjes për pastërtinë dhe higjienën – një element i pandashëm i kulturës ushtarake.

Uniforma ushtarake vishet me kujdes, çdo palosje ka kuptim, çdo detaj përfaqëson respektin për simbolin dhe flamurin kombëtar. Studentët e rinj mësojnë se disiplina nuk është vetëm urdhër, por mënyrë jetese.

Nga auditorët tek stërvitjet – mësimi i ligjit dhe armës

Në orën 08:10, fillon procesi mësimor. Auditorët e Bunavisë mbushen me qetësi e përqendrim, ndërsa zhvillohen modulet themelore: “Rregullorja e Ligjshmërisë”, “Rregullorja Rreshtore” dhe “Përgatitja e Zjarrit”.



Në orët e ligjshmërisë, studentët njihen me bazat juridike të veprimtarisë ushtarake me ligjin e disiplinës, të përgjegjësisë dhe të sjelljes nën uniformë. “Ushtaraku është përfaqësues i ligjit,

shembull i drejtësisë dhe integritetit”, shpjegon pedagogu i modulit, ndërsa auditorët ndjekin me vëmendje çdo fjalë.

Në modulën e rregullores rreshtore, studentët

mësojnë sjelljen dhe qëndrimin para eprorëve, komandat, drejtqëndrimin dhe veprimet kolektive. Këtu, më shumë se kudo, kuptohet se forca e ushtrisë qëndron në unitet dhe respektin e hierarkisë.

Ndërsa në modulën e përgatitjes së zjarrit, studentët njihen me armët kryesore të këmbësorisë, mësojnë rregullat e sigurisë dhe teknikën e përdorimit. Në çdo qitje, ata kuptojnë se arma është përgjegjësi – një simbol që kërkon vetëpërmbytje dhe profesionalizëm.

Një ditë nën rregullin e orës ushtarake

Në orën 13:00, zëri i komandës “Në mensë!” thyen ritmin e mësimi. Studentët rreshtohen për drekë, ku çdo rregull, nga hyrja në mensë deri te ngritja nga tavolina, është pjesë e edukimit ushtarak. Pushimi është i shkurtër, por i vlefshëm për të rikuperuar energjitë dhe për të reflektuar mbi përvojat e ditës.

Pasdite, në orën 16:00, rikthehet përgatitja fizike dhe pastrimi i ambienteve. Çdo detaj kontrollohet me përpikëri nga oficeri i ditës, që mbikëqyr respektimin e disiplinës. Në orën 18:30 zhvillohet darka, e ndjekur nga momentet e reflektimit dhe studimit individual në orën 19:30. Në këtë orë, çdo student përqendrohet në detyrat





e marra, duke forcuar njohuritë dhe përgatitur mendjen për sfidat e ardhshme.

Në orën 21:30 kryhet kontrolli i mbrëmjes dhe jepen porositë për ditën pasuese. Në orën 22:00, komanda “Gjumë!” shënon fundin e ditës. Por edhe atëherë, jeta ushtarake nuk ndalet: zhvillohet instruktazhi dhe kontrolli i dijeve mbi shërbimin



e postës së fjetinës, ku studentët mësojnë gatishmërinë dhe vigjilencën, cilësi që e dallojnë ushtarakun nga çdo profesion tjetër.

Pesë javë që
ndryshojnë gjithçka

Trajnimi bazë në QAPU zgjat pesë javë intensive. Çdo ditë është një përballje me lodhjen, por edhe një fitore e karakterit. Studentët mësojnë të punojnë në grup, të respektojnë urdhrat dhe të vendosin interesin e kolektivit mbi atë personal. Kjo periudhë kulmon me realizimin e dy qitjeve familjarizuese dhe testuese me armët e këmbësorisë – një provë e aftësisë, përqendrimit dhe besimit në vetvete.

Në fund të këtij udhëtimi, çdo student e ndien ndryshimin. Nga një civil i zakonshëm, ai është shndërruar në një njeri me mision, një mbrojtës të paepur të vlerave të Atdheut.

Nën udhëheqjen e komandantëve, pedagogëve dhe grupit komandues, ata dalin nga Bunavia më të fortë, më të disiplinuar dhe me një ndjenjë të re përkatësie.

Një shkollë jete
nën uniformë

Trajnimi bazë në Bunavi nuk është thjesht një fazë përgatitjeje, por një shkollë jete. Aty mësohet se disiplina është liri, bashkimi është forcë dhe respekti për uniformën është nder. Në çdo hap, studentët ushtarakë mësojnë se të jesh pjesë e Forcave të Armatosura është më shumë se një profesion – është një thirrje, një përkushtim për të mbrojtur flamurin dhe sovranitetin e vendit. Në Bunavi, civilët vijnë me ëndrra, por largohen si ushtarakë me karakter, guxim dhe dashuri për Atdheun. Dhe ky është transformimi më i bukur që ndodh mes kodrave të qeta të Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarit, ku çdo ditë lind një brez i ri mbrojtësish të Shqipërisë.

NGA KONISPOLI NË ÇAMËRI: Kufiri që i bashkoi luftëtarët e lirisë



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Brezi kufitar, fushë beteje
dhe urë bashkëpunimi
gjatë Luftës Antifashiste

Në periudhën e Luftës Nacionalçlirimtare, brezi kufitar jugor i Shqipërisë u kthye në një nga zonat më të rëndësishme strategjike. Luftimet në Shqipërinë e Jugut dhe në kufi me Greqinë Veriperëndimore, angazhuan forca të mëdha të pushtuesve italianë e gjermanë, të cilët kërkonin kontrollin e rrugëve dhe nyjave të rëndësishme që lidhin dy vendet.

Nga fundi i vitit 1943 deri në fillim të vitit 1944, njësitë partizane shqiptare bashkëpunuan ngushtë me forcat greke të EAM-it në luftime të përbashkëta në Kostajan e Llavdan. Shtabi i Zonës së Parë Operative (ZIOp) raportonte për përmirësimin e bashkëpunimit politik dhe ushtarak midis forcave të të dy vendeve.

Konispoli,
nyje strategjike

Krahina e Konispolit u vlerësua si një pikë lidhëse me rëndësi të madhe midis kufirit dhe bregdetit. Për pushtuesit, ajo ishte një hallkë strategjike; për Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, një bazë për veprime të mëtejshme. Në prill të vitit 1944, forcat gjermano-balliste sulmuan zonën me afro 3.000 trupa, por u përballën me qëndresën e Grupi 4-t Partizan, me ndihmën e Regjimentit të 15 të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Greke (ELLAS).

“

NGA FUNDI I VITIT 1943 DERI NË FILLIM TË VITIT 1944, NJËSITË PARTIZANE SHQIPTARE BASHKËPUNUAN NGUSHTË ME FORCAT GREKE TË EAM-IT NË LUFTIME TË PËRBASHKËTA NË KOSTAJAN E LLAVDAN. SHTABI I ZONËS SË PARË OPERATIVE (ZIOp) RAPORTONTE PËR PËRMIRËSIMIN E BASHKËPUNIMIT POLITIK DHE USHTARAK MIDIS FORCAVE TË TË DY VENDEVE.

Veprimtaria shqiptaro-greke
në Çamëri

Në dokumentet e ZIOp theksohej rëndësia e përfshirjes së elementëve shqiptarë të Çamërisë në organizimin e luftës, përmes kuadrove si Sulejman Mushi, Teme Sejko, Vehip Huso, Mustafa Huso e Avdul Demi. U synua krijimi i njësisë të përbashkëta në Çamëri, si simbol i luftës së përbashkët kundër okupatorit.

Një rol të veçantë në këtë bashkëpunim luajti “Protokolli i Konispolit” (10 gusht 1943), që parashikonte organizimin e minoritetit grek në kuadër të Frontit Nacionalçlirimtar.

Minoriteti grek dhe
pjesëmarrja në Luftë

Minoriteti grek në Shqipëri u përfshi gjerësisht në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, duke formuar njësi të rëndësishme si batalionet “Thanas Ziko”, “Lefter Talo” dhe “Pandeli Boçari”. Nga këto formacione u ngrit Grupi i 4-t Partizan (tetor 1943) dhe më pas Brigada XIX Sulmuese (gusht 1944). Këto struktura dëshmojnë për bashkëjetesën dhe bashkëluftimin e shqiptarëve dhe grekëve në një qëllim të përbashkët.

Figura e Rexhep Plakut

Një nga figurat më të spikatura të kësaj periudhe ishte Rexhep Plaku (1900–?), nga Konispoli, anëtar i Shtabit të ZIOp, komandant i Grupit të 4-t Partizan dhe më pas i Brigadës XIX Sulmuese. I formuar në Itali dhe pjesëmarrës në Luftën e Vlorës, ai ishte ndër organizatorët kryesorë të Batalionit “Çamëria” dhe një figurë që kontribuoji në forcimin e bashkëpunimit midis popullsisë shqiptare dhe minoritetit grek.

Bashkëpunim përtej frontit

Përveç luftimeve, bashkëpunimi shqiptaro-grek shtrihej edhe në fusha të tjera, si ndihma materiale, mjekësore dhe logjistike. Partizanët shqiptarë u mjekuan në spitalet e ELLAS-it, ndërsa popullsia greke përgjatë kufirit tregoi mikpritje e solidaritet. Këto përvoja krijuan lidhje njerëzore e vëllazërore që shkonin përtej bashkëpunimit ushtarak.

Trashëgimia historike

Luftimet në brezin kufitar dhe bashkëveprimi midis Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe asaj Greke mbeten dëshmi e një kapitulli të rëndësishëm të historisë sonë, ku lufta kundër pushtuesit u shoqërua me ndërtimin e urave të miqësisë dhe respektit ndërmjet dy popujve fqinjë.

81-vjetori i çlirimit të Korçës

Korça, qyteti i arsimit dhe i kulturës kombëtare, u çlirua më 24 tetor 1944, pas një beteje të lavdishme që shënoi një nga fitoret më të rëndësishme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë. Kjo ditë, që sot shënon 81 vjet nga fitorja e madhe, kujtohet me respekt e krenari nga brezat që e trashëguan lirinë si fryt të gjakut dhe sakrificës së popullit korçar.

Lufta për çlirimin e Korçës

Në vjeshtën e vitit 1944, Lufta Nacionalçlirimtare kishte hyrë në fazën përfundimtare. Forcat gjermane, të përqendruara në qytetet kryesore, përpiqeshin të mbanin të hapura rrugët e tërheqjes drejt Jugosllavisë.

Në këtë situatë, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, me urdhër të gjeneral-kolonel Enver Hoxhës, organizoi operacionin për çlirimin e Korçës. U krijua Brigada IX Sulmuese, me në përbërje batalionet “Hakmarraja”, “Skënder Çaçi”, “Fuat Babani”, “Reshit Çollaku” dhe “Tomori”, si dhe njësitet guerile të qytetit.

Luftimet filluan më 18 tetor 1944, duke përfshirë të gjithë qarkun e Korçës.

Më 19 tetor u çlirua Leskoviku, më 20 tetor Erseka, ndërsa në ditët në vijim u zhvilluan betejat të rrepta në Qafën e Qarrit, Devoll dhe Bilisht.

Më 23 tetor, qyteti i Korçës ishte plotësisht i rrethuar nga forcat partizane. Armiku tentoi të çante rrethimin me tanke dhe artileri, por pa sukses.

Në orët e para të mëngjesit të 24 tetorit, forcat e Brigadës IX dhe njësitë guerile të qytetit u hodhën në sulm të përgjithshëm. Luftimet ishin të ashpra në drejtim të prefekturës, mitropolisë dhe varrezave të francezëve. Pas disa orësh luftime, në orën 15:00 të datës 24 tetor, Korça u çlirua. Armiku la pas dhjetëra të vrarë, shumë të plagosur dhe sasi të konsiderueshme armatimesh.

Brigada IX Sulmuese, Krenaria e Korçës

E formuar më 16 tetor 1944, në Lozhan të Korçës, Brigada IX Sulmuese ishte një nga formacionet më të lavdishme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Në përbërje të saj ishin 1580 partizanë, të armatosur pjesërisht me armë të dhuruara nga populli dhe ndihma aleate të hedhura me parashutë.

Në të njëjtin operacion morën pjesë edhe brigadat II dhe XX, duke e çuar numrin e përgjithshëm të luftëtarëve në mbi 3.000 trima.

Pas çlirimit të qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit, brigada mori detyrën e mbrojtjes së kufirit jugor ndaj provokimeve greke dhe më vonë u vendos në Shqipërinë e Mesme, në zonën Krujë–Ishëm–



24 TETOR 1944 – DITA QË
SHËNOI FUNDIN E PUSHTIMIT
NAZIFASHIST NË JUGLINDJE

Kavajë. Në radhët e saj u rritën kuadro të aftë ushtarakë, shumë prej të cilëve do të shërbenin më pas në themelimin e Ushtrisë së rregullt Shqiptare.

Festa e Lirisë - 25 Tetor 1944

Një ditë pas fitores, më 25 tetor 1944, qyteti i Korçës u mbush plot me flamuj kuqezi dhe shalle të kuq. Populli përshëndeste bijtë e tij partizanë që parakalonin ngadhënjimtarë nëpër rrugët e qytetit. Kori miks i Korçës këndoi këngë patriotike e partizane, ndërsa kompozitori Kristo Kono prezantoi veprën e tij kushtuar kësaj dite historike, himnin e Korçës së lirë dhe krenare.

Ky ishte momenti kur liria mori zë, tingull e melodi, duke u

gdhendur në kujtesën e përhjetshme të qytetit.

Korça - Simbol i Lavdisë Kombëtare

Korça ka qenë dhe mbetet një nga vatrata më të ndritura të patriotizmit shqiptar. Që nga Rilindja Kombëtare, ajo ka qenë qendër e arsimit, kulturës dhe rezistencës. Në Luftën Nacionalçlirimtare, mbi pesë brigada partizane kishin në përbërje djem e vajza korçare, dëshmi e kontributit të madh të këtij qyteti në çlirimin e Atdheut.

Sot, pas 81 vitesh, kujtimi i atyre ditëve të lavdishme mbetet gjallë në çdo zemër shqiptare. Lavdi e përhjetshme dëshmorëve të rënë për lirinë e Korçës dhe gjithë Shqipërisë! Nderim brez pas brezi partizanëve të Brigadës IX Sulmuese dhe popullit heroik të Korçës!





Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në mirënjohje për veprimtarinë profesionale ushtarake, patriotike e shoqërore të birit të Kuçit të Labërisë, Kujtim Bishaj, që ka shërbyer plot dinjitet në radhët e Gardës së Republikës dhe në detyra të tjera si dhe Kryetar i OKDA-së Njësia Administrative nr. 3 në Tiranë, Kryetar i Shoqatës Kulturore Atdhetare “Vëllazërimi Kuçiot”, kryetar i Nëndegës së Labërisë të Njësise Administrative nr.3 në Tiranë, njerëzor, me dije e kulturë që rrezaton mirësi dhe shpirtgjerësi, por që zyrën dhe muzeun “Xhevat Lluri” e ka kthyer në një vatër kulture, bibliotekë dhe pikë takimi të rëndësishëm të brezave.

Kuçi me rrënjë të thella labe

Kushdo që është nga Kuçi i Labërisë e thotë me krenari: “Jo për mburrje, por jam nga Kuçi”. Po cili është ky fshat me histori e traditë luftarake në historinë e kombit shqiptar. Nga thellësia e shekujve flet historia, trimëritë, heroizmat në mbrojtje të identitetit, truallit arbëror, ky fshat i etiketuar si “Kuçi i dëshmorëve”, i kulturës e traditës, vendbanimi tipik i Labërisë. Natyrshëm të jesh në Kuç nënkupton eksperiencë tipike labe. Tërë fshatrat e tjera, që kanë dallime prej Kuçit, prej banorëve të Kuçit konsiderohen si devijime nga tradita e vërtetë labe. Kënga, trimëria, lavdia janë pjesë e Kuçit që shekujve janë përballur me barbaritë romake, bizante, osmane, normande, veneciane, greke, italiane e gjermane, janë përballur me të keqen dhe kanë triumfuar mbi të. Kuçi është vend mahnitës me peshë në krenarinë kombëtare, ku në shkrime e gjejmë, “zërra e kryengritjeve”, e luftës, e triumfit, e kuvendeve, vend që të frymëzon imagjinatën edhe përtej realitetit historik. Kur themi kuçjot nënkuptojmë labin tipik, burrëri, shkathësi, energji, temperament dinamik, vitalitet, kulturë dhe traditë. Në këtë sofër të labërishtes, në Kuçin e njohur të Labërisë është lindur edhe ushtaraku profesionist dhe veprimtari i njohur shoqëror Kujtim Bishaj, bir i këtij fshati të mirënjohur jo vetëm për trevën kaonike por për mbarë truallin shqiptar. Kuçi i Kujtim Bishaj dhe qindra-mijëra të tjerëve të lindur 620 m mbi nivelin e detit, 62 km larg Vlorës, që shtrihet rrjedhës së lumit të Shushicës, i rrethuar nga kurora të bukura me male të larta dhe pyje. Lugina e Shurit e Gryka e Zarelit bën lidhjen e Kuçit me Kurveleshin e sipërm, Progonatin, Golemin, Gusmarin, një rrugë 15 km nga rrugët turistike të vendit, që kalon kanionin mahnitës të Grykës së Lepushkës, përroit të Dushoberit e të Zarelit dhe përroin e Shurit që zbret nga buza e Dervenit dhe Qafa e Gomarshit, ndërsa simbolikisht në pjesën e detit fshati është në pikënisjen e luginës së Borshit dhe shtrihet drejt juglindjes, drejt detit. Të dhënat historike na çojnë thellë në histori. Historiani turk Halil Inalxhik shpreh: “..në 1431 Kuçi kishte 49 shtëpi me 180 banorë..”, ndërsa më 1942 rreth 500 shtëpi me 4000 banorë ndërsa sot si në gjithë trevën labe ka firuar shumë numri. Buronjat janë fillesa e një fshati përmendoresh si ajo e kapedanit të Labërisë Zenel Hito Gjolekës në mes të fshatit, një trim luftëtar që udhëhoqi labët kundër reformës së Tanzimatit të Perandorisë Osmane, 1830-1848, një përmendore e poetit dhe shkrimtarit të Rilindjes Kombëtare, që i bëri një vlerësim dedikues Kuçit, kur udhëtoi në zonat e Kurveleshit dhe vizitoi fshatin, më 1887, kur ishte 21 vjeç, ndërkohë që më 1903, Çajupi shkroi një poemë me 64 vargje, publikuar në “Baba Musa Lakuriq”. Ja vargjet çajupjane: “Grykë e Kuçit kush ka shkuar,/ dhe gjaku si ka qëndruar,/ udhëtari nga të vejë,/ mal këtej e mal andej,/ në mes një lumë i harbuar,/ vërtitet duke gulçuar,/ Ç’vend i egër a i butë,/ Kërren trima si të tutë..”. Në luftën epike të Vlorës, Kuçi nxori pesë çeta luftëtarësh dhe më tej Kuçi mbledhi rreth vetes kuvendarët e Labërisë, më 28 nëntor 1924, ku mori edhe përsëndetjet e burrit të shquar Fan Nolit, që nuk pati mundësinë të ishte prezent në kuvend në Kuç. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, Kuçi nxori 600 luftëtarë ndërkohë që kishte 400 shtëpi me rreth 3000 banorë, nga të cilët 105 ranë dëshmorë, 5 heronj të popullit. Fshati, edhe pse u dogj katër herë nga nazifashistët, nuk u përkul kurrë. Kuçi ka folur edhe me vlerave historike, kulturore dhe intelektuale, me kuvende e Kanunin lab si një sistem normash ligjore popullore. Nëse flasim për “Kuçin legjendar”, ia vlen të perifrazojmë Ismail Kadarenë që thotë se “..Kuçi ka prodhuar më shumë heroizma se grurë”.

Origjina dhe rrënjët familjare, pasaporta e përjetësisë

Kujtim Bishaj është lindur më 25 janar 1951, në fshatin Kuç të Kurveleshit, që dikur ka qenë përfshirë në rrethin e Vlorës, ndërsa aktualisht i përket Bashkisë së Himarës. Ai erdhi në jetë në një truall të njohur atdhetar. Kujtimi është me prejardhje nga një familje me tradita të forta atdhetare e patriotike, por edhe e lidhur ngushtësisht me LANÇ-in. Ai u rrit në një oxhak familjar që e ushqe me dashurinë njerëzore me traditat, zakonet e doket e zonës së Kuçit, Kurveleshit dhe më gjerë, kultivoi vetitë më të mira të familjes së tij. Familja e Kujtim Bishajt kishte qenë pjesë e traditës luftarake, që në kohën e kryengritjeve të mëdha antitanzimat, që udhëhiqeshin nga Zenel Gjoleka dhe më tej farefisi i tij ka luftuar kundër pushtuesve osmanë, kundër okupatorëve të fqinjëve tanë jugorë në vitet 1878, më 1897 për Janinën, në luftën kundër andartëve grekë, më 1913-1914. Gjithashtu aktiviteti luftarak i këtij fshati me emër në Shqipëri ka qenë aktivizuar masivisht edhe në luftën çlirimtare të Vlorës më 1920-ën, si dhe masivisht që nga fillimi kur vendi u pushtua nga okupatorët italianë e gjermanë, iu

Kuçi i Dëshmorëve: Labëria që frymëzon, Kujtim Bishaj dhe trashëgimia e trimërisë



bashkua kauzës së madhe të forcave partizane, për liri e çlirim kombëtar. Prejardhja e kësaj familje patriote flet qartë jo vetëm për pjesëmarrjen në luftë, por edhe për gjakun e derdhur për atdhe dhe njerëzit e tij të afërm janë sot në panteonin e kombit me titullin e lartë të nderit, dëshmorë të Atdheut. Prindërit e Kujtimit gëzonin respekt jo vetëm në fshat por edhe në krahinë e më gjerë. Babai i tij Ali Axhem Bishaj (1918- 1997) ka qenë martuar me Xheko Bilbil Balilin. Aliu ishte partizan në Br6S, dhe më tej ka punuar pas fitores mbi pushtuesit dhe çlirimit të Shqipërisë në fabrikën e orizit në Vlorë, në Kuç me tregti, deri më 1953, ndërkohë që kur Kota u bë “rreth”, punoi në Kotë në ndërmarrjen e grumbullimit, në tregti, në gjendje civile të Kotës. Ndërsa së fundi punoi edhe në NB “Kanan Maze” në Kotë. Rrethi i Kotës funksionoi rreth 10 vjet, që edhe pse trashëgimia e gjyshit të tij ishte jetëshkurtër, pasi gjyshi ndërroi jetë më 1918, nga gripi spanjoll, familja e Ali Bishaj, babait të Kujtimit, trashëgoi vetitë më të mira njerëzore të fshatit Kuç. Natyrshëm traditat e mira i vijoi i biri, Kujtim Bishaj që është rritur dhe edukuar me dashurinë e prindërve të tij të mirë. Nga të dhënat dokumentare rezulton se, Ai ka kryer arsimin shtatëvjeçar në Kotë të Vlorës që në atë periudhë ka qenë qendër lokaliteti, duke sakrifikuar dhe bërë goxha rrugë për të mësuar dhe këtë e arriti me përvetësim e me rezultate shumë të larta në mësim. Më pas kryen studimet në shkollën e mesme profesionale politeknikum, specialiteti “Radioteknik” në Tiranë, për të cilin mori edhe vlerësimet më maksimale.

Në vitin 1970-1972 kryen shërbimin ushtarak në institucionin elitari të Gardës së Republikës së Shqipërisë, në shërbimin e Radiondërlidhjes, si një detyrë shumë e rëndësishme për sigurinë e personaliteteve dhe udhëheqjes së kohës, duke garantuar shërbimin e pandërprerë të komunikimit në radiondërlidhje. Kujtimi është dalluar për korrektësinë në zbatimin e detyrave, urdhrave rregulloreve dhe të disiplinës korrekte në pozicionin që kishte. Ndërkaq pas përfundimit të shërbimit ushtarak me kërkesën e tij si dhe me miratim nga institucioni përkatës, Kujtim Bishaj kërkoi që të shërbente si ushtarak aktiv në Gardën e Republikës. Kështu nisur nga vlerësimet shumë pozitive dhe arritjet sinjifikative në shërbimin që kryente, iu besuan detyra shumë të rëndësishme në grupin e shërbimit pranë personaliteteve të larta shtetërore shqiptare. Gjatë periudhës së kryerjes së detyrave ushtarake, por dhe atyre shoqërore është dalluar për zbatimin me korrektësi të lartë të tyre, të vlerësuar nga instancat eplore të Gardës së Republikës.

Kujtim Bishaj ka shërbyer në Gardë si ushtarak aktiv për dy dekada rresht, nga viti 1973 deri në vitin 1993, duke punuar sipas detyrave dhe ligjeve në strukturat e Gardës së Republikës. Për këtë periudhë është vlerësuar dhe nderuar për korrektësinë dhe disiplinën në zbatimin e detyrave. Me ndryshimet politike dhe demokratike që ndodhën në vendin tonë, Kujtim Bishaj me shokë e kolegë të tjerë të Gardës ishin në fokus të valës së ndryshimeve e largimeve nga puna edhe në mënyrë fare të pa arsyeshme. Kështu ai është liruar nga detyra si ushtarak dhe kaloi në rezervë, ku arsyet e tranzicionit politik ishin të pleksura me tranzicionin shtetëror. Pas daljes në rezervë, në vitin 1993, në një moshë të konsiderueshme të re dhe me mjete financiare minimaliste për jetesën e familjen e tij, ai, si dhe të gjithë shokët dhe kolegët e tjerë që patën të njëjtin fat si Kujtimi, filluan të shikonin se si të mbijetonin, pasi drejtuesit e pushtetit dhe shtetit të kohës me zgjedhjet e para demokratike hoqën nga puna kategori atdhetare, që i kishin shërbyer denjësisht dhe krenarisht shtetit, kombit shqiptar, dhe një nga këta që familja kishte derdhur gjak për lirinë e Atdheut sikurse ishte Kujtim Bishaj. Fakt është se për periudhën u quajt “i papërshtatshëm” për të vijuar punën në institucionin e Gardës, ndërkohë që në punën e tij ka pasur vetëm lavdërime e falënderime, vlerësime maksimale të eprorëve kolegëve dhe vartësve. Kujtimi ishte dhe mbeti pjesë vitale e vlerave të shoqërisë sonë, që kishte punuar gjithmonë me besnikëri dhe me ndershmëri, por dhe kishte përmbushur edhe kërkesat dhe obligimin rigoroz ndaj betimit ushtarak, betim që e bënte krenar për të shkuarën familjare, për vlerat që përfaqësonte, për gjakun e dëshmorëve që kishin derdhur gjak për këtë shtet si dhe që në fakt ishte betuar para flamurit dhe Atdheut. Gjatë periudhës që shërbente në Gardën e Republikës, në vitin 1984 ka qenë edhe anëtar i Këshillit Popullor të Lagjes Nr.10, të kryeqytetit, Tiranës, detyrë që e kryen me korrektësi e dinjitet duke qenë aktiv në mbledhjet e këshillit duke ngritur probleme që shqetësonin komunitetin që ai i

përfaqësonte si i zgjedhur nga populli dhe në shërbim të popullit.

Përfaqësues dinjitoz në organizatat shoqërore, jetë aktive në mbështetje të komunitetit

Në rrugëtimin jetësor të tij, Kujtim Bishaj nuk ka qëndruar asnjëherë indiferent ndaj problemeve shoqërore të lagjes ku banon. Ai edhe ndaj sfidave ka qenë në vijimësi pjesë e strukturave shoqërore si anëtar i SHAK “Labëria” që me themelimin e saj dhe më tej edhe pjesë e strukturave drejtuese si sekretar, por edhe si kryetar i nëndegës së Labërisë së Njësise ku banon (Nj. Ad.3). Natyrshëm është trashëgimia e një fshati me rrënjë dhe me dashuri njerëzore, pasi për Kuçin ka edhe me dhjetëra libra, gjenden edhe kryevepra kolosale me 3000 faqe, ku janë pasqyruar 25.209 emrat e 136 fiseve që ka Kuçi, të paraqitura në tabela genealogjike, me 2900 fotografi ilustruese, me 9500 emra të shkruar nga Seit Alikaj, ku çdo lexues do të gjejë befasi të këndshme dhe mahnitëse, hajmali e pasuri, jo stoli bibliotekash, por enciklopedi të veçanta mençurie. Një prej tyre është edhe biri i Kuçit heroik Kujtim Bishaj. Kuçiotët festojnë ditën e çlirimit të Kurveleshit, 25 qershorin, ndërkohë që janë i vetmi fshat në vend që ka varrezë dëshmorësh (një ndër 36 grup-varrezat e dëshmorëve në Republikë). Janë të shumë ata që kanë shkruar për Kuçin por ne përzgjedhëm një gjeneral lufte: Shefqet Peçi i burgosur në burgun e Gjirokastrës shkroi: “Kuçi në gropë e në anë,/ do këndojë me krenari,/ I vanë trimat partizanë,/ brigadierit në shtëpi,/ lirona shokët tanë,/ gabohu me dhelpëri,/ gjithë fshati mori armë,/ tregoi besnikëri... Uroj Kurveleshin mbarë/ të marrë shembell aty”. Brumi atdhetar kuçiot rronte në çdo zemër, në çdo shtëpi dhe tek oxhaku familjar “Bishaj”, kjo trashëgimi që manifestohej tek ushtaraku profesionist dhe veprimtari Kujtim Bishaj. Kujtimi është angazhuar në Organizatën e Veteranëve të LANÇ-it dhe si pasardhës veterani, në Njësinë Administrative nr.3, nga 14.8.2003 e në vijimësi si dhe i spikatur është kontributi i çmuar në mbrojtje të vlerave themelore dhe idealet e LANÇ-it, ku vetë familja e tij vjen nga kjo shtresë shoqërore, që rrënjët e lirisë janë vaditur me gjak të familjarëve dhe rrethit familjar, ku natyrshëm është i njohur, se fshati i tij është tërësisht i lidhur me LANÇ-in që është një fshat tejet i martirizuar. Nga ana tjetër Kujtim Bishaj është aktiv dhe korrekt si familje dëshmorësh të LANÇ-it, pasi ai është zgjedhur në mënyrë unanime Kryetar i Organizatës së Dëshmorëve të Njësise Administrative tre, që prej tetë vitesh, pra nga viti 2016 e në vijimësi. Kujtimi dallon nga të tjerët bashkëpunëtorë dhe anëtarë e drejtues të nivelit të tij, për kontribute në drejtëm të forcimit të punës në Njësinë administrative nr.3 të Tiranës, duke qenë edhe i zgjedhur në forumet drejtuese si anëtar i Asamblesë Organizatës Kombëtare të dëshmorëve të LANÇ-it dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut, por edhe anëtar i asamblesë OKDA, ku dallon sjellja e tij për komunikim të vijueshëm me njerëzit, si një aktivist mjaft njerëzor i palodhur dhe i kudogjendur. Nga ana tjetër aktualisht përveç detyrës si kryetar i OKDA më 16.2.2024 është zgjedhur në detyrën e Sekretarit të OVPA të Këshillit zonal të lagjes pranë “Oxhakut” në Tiranë. Në punën dhe detyrat e kryera është vlerësuar me stimuj të ndryshëm dhe me urdhra e medalje nga instancat ligjore si dhe asnjëherë nuk i ka parë vlerësimet si privilegj e stoli, por si pjesë e përgjegjësisë në detyrat shoqërore e vullnetare.

Është tashmë një fakt i njohur se zoti Kujtim Ali Bishaj ka dëshmorë, dy djem të hallave, të motrave të babait dhe më konkretisht Ali Rrapo Aliaj nga Kuçi si dhe Alem Arshi Brahimaj nga Kuçi. Nga libri “Dëshmorët e Atdheut”, botimi i vetëm zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes (2012), gjejmë se Ali Rrapo Aliaj ishte lindur në Kuç dhe ka rënë më 1944 në Sarandë, është i shpallur me titullin e lartë “dëshmor i Atdheut”, me vendim nr.97 datë 22.9.1972 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të rrethit të Vlorës. Alem Arshi Brahimaj ka lindur më 1930, në fshatin Kuç dhe ka rënë më 24 shkurt 1948, në Krujë (Mali i Bardhë) si dhe është shpallur dëshmor i Atdheut me Vendim nr.147 datë 31.7.1970. Mbi të gjitha vullnetarizmi dhe korrektësia e tij dallon për cilësi shumë të mira që gëzon si aktivist i Shoqatës “Labëria”, si anëtar i forumeve qendrore të saj, por dhe si një nga më të apasionuarit në lidhje me publikimet dhe shpërndarjet e tyre të gazetës së njohur dhe patriotike të SHAK “Labëria” Nderi i Kombit, që në zyrën e këshillit zonal gjendet gjithmonë jo vetëm gazeta “Labëria”, gazetë atdhetare me nerv dhe prush atdhetarie, gjithmonë në shërbim të kombit. Nuk është e rastit që, nisur nga vlerat e veçanta, Kryesia e Labërisë në Tiranë si dhe nëndegët në Tiranë, e propozuan në Kryesinë e Shoqatës “Labëria” në Tiranë, si dhe Kryesia e Përgjithshme e Shoqatës Kulturore Atdhetare “Labëria”, njëzëri vendosi që Kujtim Ali Bishajt t’i jepet vlerësimi “Personalitet i shquar i Labërisë”, me këtë motivacion: “Për kontribut të shquar si mbrojtës i idealeve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si ish-ushtarak në shërbim dinjitoz në përmbushjen e detyrave të mbrojtjes së Atdheut në strukturat e Gardës së Republikës, për kontribut të veçantë në organizimin, mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të Shoqatës “Labëria” dhe pjesëtar në gjithë kuvendet e saj, si drejtues i disa organizatave vendore të njësise nr. 3 të Tiranës, kryetar i Shoqatës Atdhetare Patriotike Kulturore “Vëllazërimi Kuçiot”, kryetar i OKDA së njësise, aktivist e veprimtar i njohur i jetës shoqërore e qytetare të kryeqytetit, duke rrezatuar vlerat më të larta të trevës së Kuçit, Kurveleshit dhe Labërisë”. Vlerësimi për patriotë e atdhetarë, që e duan vendin pa kushte, që energjitë nuk i kursejnë asnjëherë për familjen, shoqërinë komunitetin dhe meritojnë nderimin dhe respektin për cilësitë njerëzore si ish-ushtarak, familjar shembullor, i ndershëm, veprimtar dinjitoz, që ia vlen në çdo kohë për miqësinë e humanizmin njerëzor.

Bibliografia: Të dhëna nga arkivi familjar i zotit Kujtim Ali Bishaj; Të dhëna nga dosja e ushtarakut Kujtim Bishaj; Të dhëna nga libri i Zabib Cukut, “Historiku i organizatës veteranëve dhe pasardhësve të LANÇ-it” zona, Nj.Ad.3, Tiranë; Periodiku i gazetës “Labëria”, Periodiku i Revistës “Pavdekësia”, organ i OKDA-së, të dhëna nga Shoqata Atdhetare Patriotike Kulturore “Vëllazërimi Kuçiot”, të dhëna nga arkivi i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë shqiptarë.

NATO investon në trajnimin e gjeneratës së re përmes bashkëpunimit shumëkombësh

Të mërkurën, më 15 tetor, 13 aleatë të NATO-s (Kanadaja, Çekia, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Norvegjia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar) ranë dakord të fillojnë zhvillimin e një aftësie trajnimi të simuluar shumëkombëshe.

Projekti i Trajnimit Sintetik të Shpërndarë me Dukshmëri të Lartë (HVP) synon t'i përgjigjet kërkesës gjithnjë në rritje për trajnim ushtarak shumëkombësh në një mënyrë me kosto efektive. Projekti do të shfrytëzojë aftësitë ekzistuese kombëtare të trajnimit të simuluar për të krijuar një rrjet të sigurt të trajnimit virtual të avancuar dhe gjithëpërfshirës për qëllime shumëkombëshe.

Sapo të jetë e disponueshme, aftësia do ta bëjë trajnimin shumëkombësh ndër-domen më të arritshëm dhe më pak të kushtueshëm, dhe do të zvogëlojë ndjeshëm kohën e përgatitjes për planifikimin dhe ekzekutimin e ushtrimeve.

Në një ceremoni nënshkrimi të mbajtur në Selinë e NATO-s në margjinat e takimit të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme Radmila Shekerinska vuri në dukje se “projekti do t'i përgatisë trupat tona për mjedisin dinamik dhe të rrezikshëm në të cilin ndodhemi dhe do të ndihmojë në sigurimin që të kemi forcat dhe gatishmërinë luftarake të nevojshme për të



mbrojtur Aleancën”. Iniciativat shumëkombëshe si Projekti i Trajnimit Sintetik të Shpërndarë me Dukshmëri të Lartë gjithashtu ndihmojnë në maksimizimin e përdorimit të aftësive të disponueshme në të gjithë Aleancën dhe më gjerë. Projekti është i hapur për pjesëmarrje nga Partnerët Indo-Paqësorë

të NATO-s. Aleatët pjesëmarrës dhe vendet partnere do të punojnë së bashku me Agjencinë e Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) për zbatimin e projektit, duke përfshirë krijimin e një tregu që përputhet me nevojat dhe mundësitë e trajnimit të kombeve.

Bashkëpunimi shumëkombësh i aftësive



Një avion luftarak merr furnizim me karburant ajër-ajër nga një avion Transporti me Tankerë Shumëfunksionalë (MRTT), një nga aftësitë shumëkombëshe që Aleatët kanë zhvilluar së bashku.

• NATO po i ndihmon aleatët dhe vendet partnere të identifikojnë mundësitë për bashkëpunim shumëkombësh në fushën e aftësive dhe të zhvillojnë Projekte me Dukshmëri të Lartë (HVP) në fusha kyçe si furnizimi me karburant ajër-ajër, municionet, dronët, mbrojtja ajrore dhe raketore, komanda dhe kontrolli dhe trajnimi.

• Qëllimi është të ulen kostot nëpërmjet ekonomive të shkallës, duke përmirësuar njëkohësisht vlerat operacionale nëpërmjet rritjes së bashkësisë së pajisjeve, trajnimit, doktrinës dhe procedurave.

• NATO punon me Bashkimin Evropian për të shmangur dyfishimin dhe për të siguruar plotësueshmërinë e përpjekjeve.

Për të kryer operacionet, misionet dhe aktivitetet e tjera të saj, NATO ka nevojë që Aleatët të investojnë në pajisje ndërvepruese, të përparura dhe me kosto efektive. Për këtë qëllim, NATO luan një rol të rëndësishëm në ndihmën e vendeve për të vendosur se si dhe ku të investojnë në mbrojtjen e tyre. Aleanca gjithashtu mbështet Aleatët në identifikimin dhe zhvillimin e iniciativave bashkëpunuese shumëkombëshe, duke përfshirë një gamë të gjerë Projektesh me Dukshmëri të Lartë (HVP), për të ofruar aftësitë kryesore mbrojtëse të nevojshme për sigurinë e Aleancës.

Në dekadat e fundit, dinamika e sigurisë ndërkombëtare ka ndryshuar ndjeshëm, duke kërkuar nga organizatat ushtarake si NATO jo vetëm fleksibilitet strategjik, por edhe një qasje më të integruar dhe bashkëpunuese. Në këtë kontekst, bashkëpunimi shumëkombësh për zhvillimin e aftësive ushtarake është shndërruar në një shtyllë të rëndësishme të politikave të Aleancës. Nuk bëhet fjalë thjesht për ndarjen e burimeve apo për koordinim logjistik; ky bashkëpunim përfaqëson një filozofi të re të mbrojtjes kolektive, ku vendet anëtare punojnë së bashku për të ndërtuar kapacitete të përbashkëta, për të rritur ndërveprueshmërinë dhe për të garantuar që NATO të mbetet e gatshme për të përballuar sfidat e shekullit XXI.

Në praktikë, kjo filozofi është materializuar përmes një sërë iniciativash dhe projekteve të përbashkëta, të cilat synojnë të maksimizojnë efikasitetin dhe të minimizojnë kostot. Një nga format më të suksesshme është krijimi i projekteve shumëkombëshe të njohura si “High Visibility

Projects” (HVPs), ku më shumë se 20 vende anëtare bashkëpunojnë për zhvillimin e sistemeve të avancuara të mbrojtjes, komunikimit, logjistikës dhe teknologjisë. Këto projekte jo vetëm që rrisin kapacitetet operacionale të Aleancës, por edhe krijojnë një ndjenjë të thellë solidariteti dhe përgjegjësie të përbashkët. Një shembull konkret është programi MRTT (Multi Role Tanker Transport), ku disa vende kanë bashkuar burimet për të blerë dhe operuar avionë për furnizim ajror, duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetet logjistike dhe fleksibilitetin operacional.

Një tjetër komponent kyç i bashkëpunimit shumëkombësh është krijimi i qendrave të ekselencës, të cilat ofrojnë trajnime, kërkime dhe ekspertizë në fusha të specializuara. Qendra për Mbrojtjen Kibernetike në Talin është një shembull i shkëlqyer, ku ekspertë nga vende të ndryshme punojnë së bashku për të përmirësuar kapacitetet e NATO-s në fushën e sigurisë kibernetike. Këto qendra jo vetëm që rrisin nivelin e profesionalizmit dhe ekspertizës brenda Aleancës, por gjithashtu shërbejnë si platforma për shkëmbimin e njohurive dhe për ndërtimin e standardeve të përbashkëta.

Përfitimet e këtij modeli bashkëpunimi janë të shumta

dhe të prekshme. Ai mundëson një përdorim më racional të burimeve, duke shmangur dublikimet dhe duke rritur efektivitetin e investimeve në mbrojtje. Gjithashtu, ai forcon ndërveprueshmërinë mes forcave të vendeve anëtare, duke siguruar që ato të mund të operojnë së bashku në mënyrë të koordinuar dhe efikase në çdo teatër operacioni. Mbi të gjitha, bashkëpunimi shumëkombësh ndihmon në ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe në forcimin e lidhjeve politike brenda Aleancës, duke e bërë NATO-n më të bashkuar dhe më të qëndrueshme përballë sfidave të jashtme.

Bashkëpunimi shumëkombësh për zhvillimin e aftësive ushtarake është më shumë se një strategji praktike — është një shprehje e solidaritetit dhe e vizionit të përbashkët për sigurinë kolektive. Ai përfaqëson një model të suksesshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, ku fuqia e përbashkët tejkalon kufizimet individuale dhe ku Aleanca ndërton jo vetëm kapacitete ushtarake, por edhe një kulturë të përbashkët mbrojtjeje. Në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të paparashikueshme, ky model bashkëpunimi është një nga asetet më të çmuara të NATO-s dhe një garanci për stabilitetin dhe sigurinë afatgjatë të vendeve anëtare.

Seul ADEX 2025: Koreja e Jugut drejt së ardhmes së mbrojtjes me teknologji të avancuar AI

Në një epokë ku teknologjia po riformaton çdo aspekt të sigurisë globale, Koreja e Jugut po bën një hap të guximshëm drejt së ardhmes me ekspozitën më të madhe të mbrojtjes në Azinë Verilindore—Seoul ADEX 2025. Duke u zhvilluar nga data 20 deri më 24 tetor në KINTEX, Ilsan, Provinca Gyeonggi, ky event përfaqëson jo vetëm një vitrinë të arritjeve të industrisë koreane të mbrojtjes, por edhe një deklaratë ambicioze për rolin e saj në skenën globale. Me pjesëmarrjen e 600 kompanive nga 35 vende, ekspozita ka arritur përmasat më të mëdha në historinë e saj, duke reflektuar rritjen e interesit ndërkombëtar për konceptin “K-defense” - një strategji që kombinon teknologjinë vendase, inteligjencën artificiale dhe autonominë operacionale për të krijuar sisteme të mbrojtjes të gjeneratës së ardhshme.

Në qendër të vëmendjes është avioni luftarak supersonik KF-21 ‘Boramae’, një simbol i pavarësisë teknologjike të Koresë së Jugut në fushën e aviacionit ushtarak. I zhvilluar nga “Korea Aerospace Industries” (KAI), KF-21 do të shoqërohet nga një mjet ajror pa pilot shumëfunktional (AAP), i pajisur me pilotin vendas të inteligjencës artificiale ‘Kairon’. Ky bashkëpunim përfaqëson një qasje të re në operacionet ajrore, ku mjetet me dhe pa pilot bashkëpunojnë në formacione të koordinuara për të kryer misione komplekse. Vizitorët e ADEX do të kenë mundësinë të përjetojnë këtë sinergji përmes një simulimi interaktiv të luftimeve ajrore me pilotin AI, duke sjellë një përvojë të drejtpërdrejtë të teknologjisë që po formëson të ardhmen e luftës.

Një tjetër debutim i rëndësishëm është sistemi raketer ‘Chunmoo 3.0’, i prezantuar nga “Hanwha Aerospace”. Ky version i avancuar i lëshuesit të raketave të shumëfishta është i pajisur me raketa të drejtuara me precizion (L-PGW) që përdorin inteligjencën artificiale për të identifikuar objektivat gjatë fluturimit dhe për t’i goditur me dronë kamikazë. Ky sistem përfaqëson një evolucion të rëndësishëm nga artileria tradicionale drejt një platforme të zgjuar, fleksibile dhe me rrezik të ulët për personelin. Në zonën e operacioneve të përbashkëta me mjete të pilotuara dhe pa pilot (MUM-T), “Hyundai Rotem” prezanton konceptin e gjeneratës së ardhshme të tankeve që integrojnë kulla dhe dronë pa pilot, si dhe automjetin shumëfunktional “HR-Sherpa”, të optimizuar për misione të automatizuara. Ndërkohë, LIG Nex1 sjell armë ajrore me reze të gjatë veprimi për KF-21 dhe një sistem komandimi dhe kontrolli të drejtuar nga AI, i cili analizon situatat e fushëbetejës për të përmirësuar vendimmarrjen taktike.

Ekspozita nuk ndalet vetëm në prezantimin e armëve, ajo përfshin mbi 30 seminare që trajtojnë temat më të avancuara të industrisë së mbrojtjes, përfshirë inteligjencën artificiale, sistemet MUM-T dhe zgjidhjet e mbështetjes së vendimeve të drejtuara nga AI. Administrata e Programit të Blerjeve të Mbrojtjes organizon Konferencën Ndërkombëtare Detare për Sistemet me Pilot dhe Pa Pilot, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në zhvillimin e teknologjive të reja. Një pavijon i ri i Teknologjisë së Re, me sipërfaqe 2,260m², është shtuar për të promovuar ndërgjegjësimin për ekonominë hapësinore dhe sistemet ajrore kundërajrore (AAM), duke përfshirë modele të automjeteve të ripërdorshme për lëshimin e satelitëve, komunikime satelitore të avancuara dhe fibra karboni të gradës hapësinore.

Me një sipërfaqe totale prej 49,000m², Seoul ADEX 2025 përputhet me përmasat e Shfaqjes Ajrore Farnborough në Mbretërinë e Bashkuar dhe renditet e dyta në nivel global pas Paris Air Show. Numri i stendave të ekspozitës është rritur me 23.9%, duke reflektuar interesin në rritje për teknologjitë koreane të mbrojtjes. Organizatorët parashikojnë që pjesëmarrja të kalojë 300,000 vizitorë, një rritje e ndjeshme nga 220,000 në vitin 2023. Me zhvendosjen në KINTEX dhe zgjatjen e kohëzgjatjes së eventit në pesë ditë, Seoul ADEX po konsolidohet si një nga tre shfaqjet ajrore më të rëndësishme në botë. Konsultimet e biznesit priten të tejkalojnë 30 miliardë



dollarë amerikanë, duke krijuar një cikël të virtutshëm të rritjes së eksporteve të mbrojtjes dhe duke forcuar profilin global të K-defense.

Në një botë ku balanca e fuqisë po riformulohet nga teknologjia, Seoul ADEX 2025 është më shumë se një ekspozitë, është një platformë strategjike që demonstroi se Koreja e Jugut

nuk është më thjesht një konsumator i teknologjisë së mbrojtjes, por një krijues dhe eksportues i saj. Me inteligjencën artificiale në qendër të inovacionit, K-defense po shndërrohet në një model për të ardhmen e sigurisë globale. Nëse ky ritëm përparimi vazhdon, Koreja e Jugut mund të pozicionohet si një lider jo vetëm në Azinë Verilindore, por në të gjithë botën.

Ekulibri i brishtë: Diagnostikimi i rënies së planetit tonë

Në vitin 2025, çështja e shëndetit të planetit tonë është zhvendosur nga shqetësimi abstrakt në diagnozë urgjente. Toka po shfaq shenja të qarta të shqetësimit sistematik dhe provat nuk kufizohen më vetëm në revistat shkencore ose modelet klimatike - ato janë të dukshme në ajrin që thithim, ujin që pimë dhe ekosistemet që po shemben përreth nesh. Korniza e kufijve planetarë, e zhvilluar nga Qendra e Rezistencës së Stokholmit, përshkruan nëntë sisteme kritike të Tokës që duhet të mbeten brenda kufijve të sigurt të funksionimit për të mbështetur jetën. Sot, gjashtë prej këtyre kufijve janë shkelur: ndryshimi i klimës, humbja e biodiversitetit, ndryshimi i sistemit të tokës, përdorimi i ujërave të ëmbla, rrjedhat biogjeokimike dhe entitete të reja si plastika dhe kimikatat sintetike. Këto shkelje nuk janë të izoluara - ato bashkëveprojnë dhe përzihen me njëra-tjetrën, duke e shtyrë Tokën në një zonë me rrezik në rritje ku pikat e kthesës mund të shkaktojnë dëme të pakthyeshme. Komisioni i Tokës paralajmëron se tani po veprojmë jashtë hapësirës “të sigurt dhe të drejtë” për njerëzimin dhe pasojat po shpalosen në kohë reale.

Ekstremet klimatike janë bërë normaliteti i ri. Viti 2024 ishte ndër më të nxehtit e regjistruar ndonjëherë, dhe viti 2025 është në rrugën e duhur për ta tejkaluar atë. Valët e nxehtësisë po përvëlojnë kontinentet, zjarret po konsumojnë pyjet nga Kanadaja në Australi, dhe përmbytjet po zhvendosin miliona njerëz në të gjithë Azinë dhe Afrikën. Këto ngjarje nuk janë anomali - ato janë simptoma të një sistemi klimatik të destabilizuar. Raporti Global i Rreziqeve 2025 i Forumit Ekonomik Botëror rendit motin ekstrem dhe rënien e ekosistemit midis kërcënimeve kryesore për stabilitetin global. Kompanitë e sigurimeve po rikalibrojnë modelet e rrezikut, qeveritë po përplojnë të përshtatin infrastrukturën, dhe organizatat humanitare janë të mbingarkuara nga shkalla e zhvendosjes. Megjithatë, pavarësisht provave në rritje, emetimet globale vazhdojnë të rriten dhe premtimet për klimën mbeten të pamjaftueshme. Hendeku midis ambicies dhe veprimit është i gjerë - dhe po zgjerohet.

Humbja e biodiversitetit, edhe pse më pak e dukshme se ndryshimi i klimës, është po aq katastrofike. Indeksi i Planetit të Gjallë tregon një rënie prej gati 70% të popullatave të kafshëve të egra që nga viti 1970. Shkëmbinjtë koralorë po zbardhen, pyjet e shiut po zhduken dhe ligatinat po thahen. Këto ekosisteme nuk janë vetëm të bukura - ato janë jetësore. Ato rregullojnë klimën, pastrojnë ujin, pjalmojnë të korrat dhe sigurojnë ilaçe. Rënia e tyre kërcënon sigurinë ushqimore, shëndetin publik dhe stabilitetin ekonomik. Faktorët që ndikojnë në humbjen e biodiversitetit - shkatërrimi i habitateve, ndotja, mbishfrytëzimi dhe speciet pushtuese - po përshpejtohen dhe përpjekjet për ruajtjen e natyrës, ndonëse të lavdërueshme, nuk po ecin me ritmin. Emergjenca e heshtur e humbjes së biodiversitetit kërkon alarme më të forta dhe veprime më të guximshme.

Stresi i pakësimit të ujit dhe burimeve po intensifikohet. Pavarësisht përparimeve teknologjike, miliarda njerëz ende nuk kanë qasje në ujë të pastër. Lumenjtë po thahen, akuiferët po shterohen dhe ndotja nga produktet farmaceutike, plastikat dhe metalet e rënda po ndotin sistemet e ujërave të ëmbla.


Ndryshueshmëria e reshjeve dhe shkrirjes së borës e shkaktuar nga klima po prish bujqësinë dhe hidroenergjinë, ndërsa tensionet gjeopolitike mbi të drejtat e ujit po rriten. Në të njëjtën kohë, gara për materiale të energjisë së gjelbër - litium, kobalt, metale të rralla - po përsërit modelet e vjetra të shfrytëzimit, shpesh në rajone ekologjikisht të ndjeshme dhe politikisht të paqëndrueshme. Pa qeverisje të kujdesshme, kalimi në një ekonomi me karbon të ulët mund të thellojë padrejtësinë mjedisore dhe konfliktin e burimeve.

Ndotja tani është kudo. Mikroplastikat janë gjetur në placentat njerëzore, në borën e Antarktidës dhe në llogoret më të thella të oqeanit. Ndotja e ajrit vret miliona çdo vit, duke prekur në mënyrë disproporcionale komunitetet me të ardhura të ulëta dhe fëmijët. Ndotja kimike po ndryshon sistemet hormonale në jetën e egër dhe njerëzit në shtet. Perspektiva Globale e Mjedisit të UNEP bën thirrje për rregullim urgjent të subjekteve të reja, por zbatimi mbetet prapa inovacionit. Ritmi i prodhimit tejkalon aftësinë tonë për të kuptuar ndikimet afatgjata, dhe barra e provës shpesh bie mbi ata që dëmtohen dhe jo mbi ata që janë përgjegjës. Ndotja nuk është vetëm një çështje mjedisore - është një çështje e të drejtave të njeriut.

Qeverisja dhe reagimi mbeten të fragmentuara. Ka pika të ndritshme: energjia e rinovueshme po rritet, përpjekjet për ruajtjen e mjedisit kanë restauruar disa habitate dhe lëvizjet rinore po riformësojnë diskursin mjedisor. Liderhipi indigjen po fiton njohje, dhe disa qytete janë pioniere në

infrastrukturën e gjelbër dhe ekonominë rrethore. Megjithatë, koordinimi global është i dobët dhe shkalla e transformimit të nevojshëm është e frikshme. Samitet e klimës prodhojnë deklarata ambicioze, por pak angazhime detyruese. Objektivat e biodiversitetit nuk janë përmbytur dhe drejtësia mjedisore shpesh lihet mënjanë. Sfidat nuk janë vetëm teknike - është politike, kulturore dhe morale.

Për të shëruar planetin, duhet të shkojmë përtej qëndrueshmërisë drejt rigjenerimit. Kjo do të thotë që rivendosja e ekosistemeve është e rëndësishme gjithashtu, jo vetëm mbrojtja e mbetjeve. Do të thotë ridizajnimi i ekonomive për të vlerësuar shëndetin ekologjik, riimagjinimi i qyteteve si qendra të biodiversitetit dhe rezistencës, dhe ribalancimi i fuqisë për të përfshirë komunitetet e marginalizuara dhe sistemet e njohurive indigjene. Kjo gjithashtu do të thotë përballje me të vërtetën e pakëndshme: se rritja e pafundme është e papajtueshme me kufijtë planetarë dhe se barazia është thelbësore për suksesin mjedisor. Toka është elastike, por jo e pamposhtur. Në vitin 2025, ne ndodhemi në një udhëkryq. Zgjedhjet që bëjmë tani do të jehojnë për breza. A do të vazhdojmë në një rrugë degradimi, apo do të përballemi me sfidën e administrimit planetar? Përgjigja nuk qëndron vetëm në teknologji, por në vlera, vizion dhe vullnet kolektiv. Shëndeti i planetit është shëndeti ynë. Dhe koha për të vepruar është tani.



Gazeta "Ushtria" - në shërbim të vlerave kombëtare, dinjitetit dhe paqes.

Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën "Ushtria" janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.





WEST POINT®



Qendra e Personel Rekrutimit njofton se do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

JANË NË DISPOZICION 3 (TRE) TË DREJTA STUDIMI, SI MË POSHTË:

- ⚓ Akademia Ushtarake "West Point"
- ✂ Akademia Ushtarake Detare
- Akademia Ushtarake e Forcave Ajrore

1 (një) kuotë
1 (një) kuotë
1 (një) kuotë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është 14 nëntor 2025.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në numrin e tel. 0035542348588, WhatsApp +355 68 340 4896